



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Nr.4735/1 prot.

Himarë, më 15.11.2021

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës suaj për informacion datë 10.11.2021

TIRANË

Zonja _____,

Bashkia Himarë ka qenë pjesë e projektit tuaj “Njih të drejtat e tua përmes ndihmës juridike falas, mbështetur nga programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë dhe financim të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC), mbështetur kjo në marrëveshjen e përbashkët të bashkëpunimit me nr. 646 prot., datë 12.11.2020.

Në respektim të kësaj marrëveshjeje për t’ju përgjigjur kërkesës suaj për informim së pari, na lejoni të përsërisim detyrimet e marra përsipër nga secila palë në marrëveshje dhe që ishin:

IV/a. Detyrimet e Komitetit Shqiptar të Helsinkit:

- Të bëj konsultim paraprak lidhur me gjetjen e monitorimeve dhe dërgimin pranë bashkisë të raporteve, gjetjeve, problematikave të ngritura gjatë sesioneve informuese/monitorimeve, masat dhe rekomandimet që propozohen etj.
- Të ofrojë bashkëpunimin e nevojshëm për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe të atij nënligjor në kuadër të promovimit të nismave me fokus dhënien e ndihmës ligjore të garantuar nga shteti.
- Të informojë paraprakisht pikën e kontaktit dhe të marrë masat e nevojshme për realizimin e sesionit informues në një moment dhe kohë të përshtatshme, me qëllim sensibilizimin e një mase të gjerë të punonjësve të autoritetit publik dhe qytetarëve.

IV/b. Detyrimet e Bashkisë Himarë:

- Të ofrojë informacionin e kërkuar nga KShH në version statistikor dhe/ose cilësor, në përputhje me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar).
- Të marrë dhe të shqyrtojë raportet e monitorimit, rekomandimet dhe sugjerimet e dërguara nga KShH, si dhe të planifikojë punën për zbatimin e masave që do t’i vlerësojë të arsyeshme për përmirësimin e situatës.

- Të krijojë kushte dhe lehtësira për organizimin e sesioneve të informimit në ambientet e bashkisë dhe autorizimin e pjesëmarrjes së punonjësve të institucionit, me qëllim sensibilizimin e tyre.
- Të informojë KShH-në për masat e marra dhe ato që janë në proces lidhur me përmirësimin e gjendjes dhe zbatimin e rekomandimeve.

Së dyti, nisur nga sa sipër, kërkesat tuaja për informim gjenden të pavendta për ne pasi:

- Ngritjen apo jo të një qendre për ofrim të shërbimeve të ndihmës juridike parësore pranë Bashkisë Himarë e vlerësoni ju si Komitet pasi projekti ishte i juaji dhe fondet për realizimin e saj sigurisht janë të tuajat. Ne do të ishim shumë bashkëpunues në realizimin e kësaj zyre sepse kjo do të ishte në të mirën tonë gjithashtu.
- Gjithsesi Bashkia Himarë shërben si zyrë informimi për çdo qytetar në çdo rast për informacione të përgjithshme orientuese.

Angazhimi juaj, sipas marrëveshjes së përbashkët të bashkëpunimit ishte të gjente se si mund të funksiononte pikërisht dhënia e ndihmës juridike parësore në Bashkinë Himarë dhe këto gjetje presim të na bëhen të ditura prej jush në përfundim të këtij projekti me qëllim avancimin më tej të bashkëpunimit.

Gjithësesi duhet të themi se aftësia e Bashkisë Himarë është e tillë që nuk mund të ofrojë ndihmë juridike parësore dhe gjithashtu edhe ligji nr. 111/2017 nuk ia kërkon një gjë të tillë. Kësisoj për t'iu përgjigjur pikës 3, 4 dhe 5 të kërkesës suaj për informim, referuar ligjit sa më sipër dhe parashikimeve të tij këto të dhëna mund t'i gjeni pranë Bashkisë Vlorë dhe Bashkisë Sarandë dhe Zyrës së Ndihmës Juridike Parësore Falas në Vlorë dhe në Sarandë, nëse ka, përsa kohë juridiksioni gjyqësor për Bashkinë Himarë është në Vlorë dhe në Sarandë dhe ne nuk i disponojmë këto të dhëna.

Në përfundim, Bashkia Himarë shpreh edhe një herë gadishmërinë e saj për bashkëpunim për çështje të tilla të interesit të përbashkët të komunitetit tonë që do ndikojnë pozitivisht tek i gjithë komuniteti.

Me respekt,

KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro